

LIBRI



MINIERA E BULQIZËS NDËR VITE (1948-2023)

NGA BASHKIM LAMI

Faqe 6

INTERVISTA



BUKUROSH KOÇI: Në Fabrikën e Pasurimit të Kromit u investuan 5.2 milion USD

Shoqëria që drejtohet nga Bukurosh Koçi ka në shfrytëzim 6 leje minerare

Faqe 5

18 shkurti, festa e minierës. Kjo ditë konsiderohet data zyrtare e krijimit të Minierës së Kromit "Todo Manço"

BULQIZA NË 75 VITE, MINIERË DHE QYTET...

Historia me minierën e Bulqizës

PROF.DR. GAFUR MUKA

Është e sigurtë që edhe para vitit 1918, banorët e trevës së Bulqizës e kanë vlerësuar si diçka të çuditshme atë lloj guri që, në dritën e diellit, lëshonte një shkëlqim të veçantë. Ndaj kur binte fjala për të, ata e quanin "guri me xixa". Dhe kur në vitin 1918, një i huaj (italian) u interesua për këtë lloj guri, ndonjëri nga banorët, që mbase shërbente tek Hani i Duriçit, ka thënë: po gur të tillë ka me shumicë tek "Ahish-ta e Madhe". Atëbotë italiani, që duhej të merrte vesh nga punët e gjeologjisë, shkoi tek "Ahish-ta e Madhe" mbushi trastën me gurin e çuditshëm dhe e mori me vete. Nuk dihet nëse atë ditë, shoqëruesi i tij bulqizak dëgjoji për herë të para fjalën KROM, por ai kuptoi që "guri me xixa" ishte gur me vlerë. Dhe, gojë më gojë, vëndasit mësuan se atje, tek "Ahish-ta e Madhe" guri me xixa kishte vlerë, ndërkohë që i huaji shënonte në hartë që tek "Ahish-ta e Madhe" kishte KROM.

Vijon në faqen 8



- Në vitet 1983 deri 1990 prodhimi i kromit shqiptar zinte vendin e tretë në botë mbas Afrikës së Jugut dhe ish - Bashkimit Sovjetik, me një prodhim vjetor prej 650 mijë ton deri në 1.1 milion ton. Miniera ishte burimi kryesor i të ardhurave të qytetit të Bulqizës dhe gjithë fshatrave të Dibres, ku në çdo vit punonin më shumë se 5000 punonjës, duke marrë parasysh këtu edhe lëvizjet e ndryshme

NGA HALIL RAMA – MJESHTËR I MADH Faqe 2,3

KULTURË

Promovohen studimet historike të disa autorëve nga zonat e Bulqizës

HISTORI - KULTURË - LETËRSI – TRADITË, SESION SHKENCOR NË FUSHË-BULQIZË



Presidenti i "Shoqatës Bulqiza" prof.assoc. dr.Islam Dauti ju bëri të ditur pjesmarrësve vendimin e kryesisë për dhënien e çmimit "Lufti Hanku" krijuesve e botuesve të talentuar në art e letërsi

Faqe 11

REPORTAZH

Faqe 7

MBRESA NGA DARDANIA

KRYESIA E "SHOQATËS ATDHETARE KULTURORE BULQIZA", ESKURSION MBRESËLËNS NË DISA VISE TURISTIKE TË KOSVËS



PORTRET

Faqe 8



ISUF KOÇI
PROFILI I
INTELEKTUALIT
DHE DREJTUESIT
TË SHQUAR
NË SEKTORIN E
BUJQËSISË

ANALIZA

Faqe 10



"Testament"
historie që
na njuh me
luftën e madhe
kundër
serbëve
në vitet
1912-1921

Për librin e studjuesit Bashkim Lami "Qëndresa e bulqizakëve në luftërat për liri"

NGA DR.ADRIATIK BALLA

Bulqiza në 75 vite, minierë dhe qytet...

NGA HALIL RAMA – MJESHTËR I MADH

- Në vitet 1983 deri 1990 prodhimi i kromit shqiptar zinte vendin e tretë në botë mbas Afrikës së Jugut dhe ish – Bashkimit Sovjetik, me një prodhim vjetor prej 650 mijë ton deri në 1.1 milion ton. Miniera ishte burimi kryesor i të ardhurave të qytetit të Bulqizës dhe gjithë fshatrave të Dibres, ku në çdo vit punonin më shumë se 5000 punonjës, duke marrë parasysh këtu edhe lëvizjet e ndryshme



Janë pikërisht këta heronjtë e parë që do të shtrojnë trasenë nga ku do të ecnin qindra mijëra të tjerë, të cilët në 75 vite do të me prodhimin kryenin mbi 100 mijë km punime minerare.

12(1360); Galerinë B(1280) dhe Galerinë A(1200). Është edhe Pusi Nr.5A që lidh Galerinë 1280(B) me Galerinë 1200(A). Veç këtyre janë hapur shumë fornele ndihmës që kanë shërbyer për transport minerali dhe për rrugë dalje e ajrim.

PAK HISTORI...

Gati një shekull më parë, burri i mençur i Vajkalit Baba Fejza, do t'i porosiste bashkëfshatarët e tij që ta ruajnë të mos ua grabisin gurin e zi me xixa që është më i rëndë se të tjerët dhe që do të vlerësohet shumë vjet më vonë.....Dhe profecia e tij doli. Megjithëse kromi hyri në përdorim industrial relativisht vonë interesimi për të është i hershëm. Vendasit thonë që Italia me Serbinë janë konfliktuar ashpër për vendosjen e kufirit, të cilin Serbia e kërkonte në Qafë të Buallit kurse Italia e kërkonte në Fushë-Bulqizë. Pra, secili shtet kërkonte ta përfshinte në territorin e pushtuar prej tij. Kjo ka ndodhur në vitin 1918.

Në vitet e Luftës së Dytë Botërore italianët filluan prodhimin e kromit sigurisht në sasi shumë të vogla, që i transportonin me mushka. Ndoshta kjo e bëri të detyrueshme ndërtimin e rrugës automobilistike nga Klosi në Bulqizë, e cila u lidh me rrugën automobilistike të Zerqanit, që ishte ndërtuar në vitin 1932. Në këtë kohë italianët kishin instaluar një repart ushtarak në mbrojtje të minierës.

Në vitin 1943 çeta partizane e Dibres e sulmoi me armë dhe i përzuri italianët dhe që nga ajo kohë punimet për nxjerrjen e kromit u pezulluan, për të rifilluar më 18 shkurt 1948 kur zyrtarisht u krijua miniera e Bulqizës. Për 45 vite që nga ajo datë historike Bulqiza mbajti në kurriz një pjesë të madhe të buxhetit të shtetit. Por shumë pak u bë për vetë Bulqizën. Me moton "kromi çan bllokadën", pothuajse nomenklatura e kuqe e vuri Bulqizën në epiqendrën e platformës së saj për shfrytëzimin barbar të kësaj pasurie të çmuar nëntokësore. Më e dukshme kjo strategji në vitet 1980-1990 kur vetëm në zonën veriore janë hapur 8 puse vertikale dhe 8 dishenteri. Përveç këtyre janë hapur 4 puse ndihmës si A'2 i pa përfunduar, 9/5;8/5;10/12;11/14, i cili përdoret për rrugëdalje. Gjithsesi, ai që është vonuar shumë është thellimi i pusit Nr. 7 sipas projektit. Në zonën D janë hapur 3 puse që lidhin punimet nga traverbanku C (1440) deri në Galerinë 1050. Konkretisht: Pusi Nr. 4 që lidh Galerinë A, Galerinë 16(1160) dhe Galerinë 1050; Pusi Nr. 5 që lidh Galerinë C(1440); Galerinë

KA MINIERË, KA QYTET. S'KA MINIERË, S'KA QYTET!

Miniera dhe qyteti janë lidhur në mënyrë të pazgjdhshme: Ka minierë, ka qytet. S'ka minierë, s'ka qytet. Këtë apostulat, të bazuar mbi historinë e qyteteve minerare në botë e ka zbërthyer më së miri Hamza Gurra, një nga inxhinierët dhe drejtuesit e njohur të minierës së kromit dhe të Bashkisë Bulqizë. Sipas tij, Bulqiza e barakave me dërrasa e viteve '49-'50 u rrit gradualisht bashkë me minierën e saj. Në vitet 50-60 u ndërtuan disa ndërtesa njëkatëshe.

Pas vitit 1960 filloi ndërtimi i ndërtesave dykatëshe dhe vetëm pas vitit 1975 nisën të ndërtohen godina banimi tre e deri pesë katëshe. Shumë njerëz këtë e lidhin me nënvleftësimin që i bënte shteti këtij qyteti dhe ish-inxhinieri e drejtuesi Gurra nuk me merr përsipër të vërtetoj të kundërtën por një gjë është e qartë: Në vitet e para perspektiva e Bulqizës ishte krejt e pa sigurtë, kërkim -zbulimi i këtij vendburimi është bërë krahas shfrytëzimit dhe kërkimi nuk ka përfunduar edhe sot as në thellësi dhe as nga krahët. Prandaj dhe qyteti u rrit me zor krahas rritjes së zbulimit të rezervave. Qyteti i Bulqizës me rreth 2000 banorë deri në vitin 1955 u rrit deri në 18000 banorë në vitet 1995-2000. Krahas rritjes së qytetit u formuan edhe ndërmarrjet e institucionet e qytetit. Në vitet e para qyteti nuk kishte ndërmarrje komunale kështu që të gjitha punët komunale i bënte ndërtimi i minierës ose bëheshin me punë vullnetare. Në vitet 1985-87 u ndërtua lagja e re e quajtur "Qyteti i ri" ku u strehuan rreth 1000 familje. Pas viteve 90 kur filloi pluralizmi qyteti u përshtat shumë shpejt me mënyrën kapitaliste të jetesës. Me ndarjen e Bulqizës rreth më vite (deri atëherë në juridiskionin e rrethit Dibër) dhe aktualisht si një nga 61 bashkitë e vendit, u strukturua mjaft shpejt administrata lokale dhe jo vetëm që nuk pati probleme por përkundrazi jetesa u përmirësua mjaft. Në mënyrë të veçantë e përmirësoi jetesën tregu privat. Megjithatë, aktualisht qyteti i Bulqizës vuan plagën e papunësisë dhe të mungesës së infrastrukturës bashkëkohore.

Shtatëdhjetëepesë vjet më parë, në "Ahishtën e madhe" të Malit të Duriçit, shpërthimi i parë i minave që thërrmonin shkëmbin e gurit me xixa sinjalizoi fillimin e punës për nxjerrjen e mineralit të çmuar të kromit në Bulqizë. 18 shkurti i vitit 1948 shënon kështu krijimin zyrtarisht të minierës më të madhe të kromit në vend. Pikërisht mbi luginën e Vajkalit, e cila në analet e historisë tonë kombëtare ka hyrë si një nga sheshbetejat kryesore kundër pushtuesve turq, të udhëhequra nga Heroi ynë Kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeu, miniera e sapokrijuar do ta bënte edhe më të njohur këtë luginë ku do të hidhte shtat qyteti minator në prehër të maleve, nga thellësia e të cilave do të nxirreshin mbi 15 milionë tonë krom. (Në vitin e parë të punës në minierën e Bulqizës u prodhuan 10482 ton mineral kromi). Është kjo sasi tepër e konsiderueshme e mineralit të çmuar, që jo vetëm ka mbajtur peshën kryesore të ekonomisë tonë kombëtare, sidomos në katër dekada të sistemit monist, por edhe minerali me të cilin Shqipëria ka "pushtuar" tregjet e botës...

Shtatëdhjetëepesë vjet më parë, në lartësinë 1000 m mbi nivelin e detit, ishin tetë punëtorë nga Rubiku dhe trembëdhjetë punëtorë nga zona e Bulqizës që i dhanë emrin minierës së kromit Bulqizë. Në kronikat e kohës, por edhe në librat studimorë e historikë të autorëve të njohur, si Hamza Gurra, Ymer Keta, Jorgo Kola e Bashkim Lami janë skalitur emrat e minatorëve e specialistëve të parë: Osman Losha, Tosum Spahiu, Myrteza Duriçi, Gjergj Prenga, Sulejman Ruta, Hamit Duriçi, Liman Zogu, Adem Hasa, Gjin Kola, Pal Deda, Riza Duriçi, Din Hoxha, Mexhit Voci, Hysni Duriçi, Mustafa Duriçi, Liman Kola, Baftjar Fida, Ferit Lala, Haxhi Xhari, Abdulla Mehmeti, Ramadan Voci, Isuf Sula, Isuf Hoxha, Mehmet Keta, Dhimitër Kalami, Hamit Beta, Mehmet Kola, Hasan Jashari, Beqir Xhemali, Nazmi Përkola, Bajram Xheka, Tahir Nasuf Spahiu, Faredin Shehu, Mendu Qatja, Kamberr Duriçi, Uke Murrja, Ndue Tusha, Ndue Murrja, Muharrem Stafa, Dodë Preng Gjeta, Llesh Luli e Pjetër Shurbi, si dhe i Drejtori të parë të Ndërmarrjes Miniera e Kromit Bulqizë, Jorgji Traja.

BULQIZA QYTET-BURG



• *Pa mohuar aspak kontributin e qindra mijë minatorëve, inxhinierëve e teknikëve të minierës, për vetë përqendrimin e të burgosurve në kampet e këtushme gjatë viteve të diktaturës, Bulqiza mund të konsiderohet edhe si qytet-burg. Për këtë flasin statistikat e kohës*

Nëse më 1954 në Bulqizë u ngrit burgu i të dënuarve ordinerë, fillimisht me 600 të dënuar, ky kamp funksionoi për rreth 30 vjet dhe përfshinte zonat nga dishenteria e galerisë 41 e deri ndër zonën "D". Katërmbëdhjetë vjet më vonë, më 1968, Bulqizës do t'i shtohet edhe burgu tek vendi ku do të ndërtohej fabrika e pasurimit të kromit. Të burgosurit ndërtuan të gjitha objektet sipas projektit deri sa filloi montimi i makinerive. Saga e të dënuarve vazhdon edhe më tej kur në vitin 1976 Kampi i burgut mori edhe zonën "D". Madje, pas vitit 1976 kampi ka patur maksimumin e të dënuarve. Një tjetër burg u ngrit më 1985 me të burgosurit që do të ndërtonin Qytetin e Ri në Bulqizë. Një nga mësuesit e shquar të Bulqizës, z.Bashkim Lami, që ka drejtuar me kompetencë e përkushtim institucione kryesore në Bulqizën e pas '90-tës, në shënimet e tij shkruan se "Ndërtimet vazhduar me ritme të shpejta dhe në vitin 1988 u strehuan banorët e parë në këtë lagje". Madje sipas tij, "burgu u përdor edhe në objekte të tjera të rëndësishme të zonës së kromeve. Miniera e Batrës dhe e Tërnovës kanë pasur kampe të dënuarish, po kështu ndërtimi i fabrikës së pasurimit dhe ndërtimi i lagjes "Qyteti i ri" është bërë me kampe të dënuarish që janë përdorur vetëm në ndërtimin e këtyre objekteve. Në 28 vite kontributi i të burgosurve ka qenë shumë i rëndësishëm".

DISA NGA DREJTORITË E SHËRBIMET NDIHMËSE

Një minierë është pa perspektivë, nëse nuk i paraprihet më zbulimin e rezervave minerare. Këtë mision historik këtu do ta kryente më së miri Ndërmarrja Gjeologjike e Bulqizës, e krijuar që në vitin 1957, duke kryer punime për zbulimet gjeologjike për gjetjen e vendburimeve të mineraleve të dobishme dhe punime shkencore në fushën e gjeologjisë. Nga studimi tejet shkencor, por edhe skurpuloz i z.Bashkim Lami (BULQIZA NDËR VITE NË 75 VJET, 1948-2018) mësojmë se Drejtori parë i Ndërmarrjes Gjeologjike e Bulqizës ishte Ferit Alla, i cili siguroi mbështetjen e fortë të personelit inxhiniero-teknik që e quante themelin e sukseseve që synonte gjeologjia. Deri në vitet 1990 funksionoi ndërmarrja e furnizimit të punëtorëve që administronte tregtinë, mensat e punëtorëve dhe fjetoret e punëtorëve beqarë, duhet thënë drejt:

bëheshin përpjekje por shërbimi ishte shumë i dobët. Në vitet 1968-1971 u ndërtua Fabrika e pasurimit e cila u konsolidua pas vitit 1975 kur prodhimi i koncentratit u rrit në mbi 8000 ton/muaj. Fabrika merrte lëndë të parë mineral të varfër rreth 850 ton/ditë dhe prodhonte rreth 350 ton koncentrat në ditë. Minerali i varfër merrej zakonisht me përmbajtje mbi 27% dhe koncentratit dilte me mbi 48%.

Në fillim të viteve '90, në mbështetje të minierës u krijua edhe parku automobilistik i Bulqizës që kryesisht ishte në shërbim të transportit të punëtorëve të minierës, por edhe të transportit të kromit transit brënda minierës e për në fabrikën e pasurimit dhe të transportit të mineralit për në Durrës.

INFRASTRUKTURA SOCIALKULTURORE

Ndër vite u ngrit gradualisht edhe infrastruktura socialkulturore. Më 1954 u ndërtua në qytet kinemaja me një skenë të vogël dhe me 200 vende, u montuan dy aparate projeksioni për të shfaqur filmat, një sallë lojërash bilardo e një bibliotekë.

Tre vjet më vonë (1957) u ndërtua në qytet shkollë e re me 7 klasa, ku u hap shkolla 7-vjeçare e ditës ku vijonin mësimin, fëmijët e Vajkalit e të qytetit të Bulqizës dhe pas 8 vitesh, më 1965 u ndërtua në Bulqizë shkollë e re me 10 dhoma mësimi, poshtë rrugës së qytetit që plotësonte nevojat për vijueshmërinë e mësimi pasi klasat u bënë me nga dy paralele. U ngritën nga mësuesit dhe nxënësit disa terrene sportive, voleybolli, basketbolli e gjimnastike, të cilat shfrytëzoheshin edhe nga rinia e qytetit të Bulqizës.

Në shtator 1967 u shkolla e mesme e përgjithshme pa shkëputje nga puna dhe më 1975 edhe shkolla e mesme profesionale e ditës me degën për teknikë miniere, që më pas u shtuan degët, gjeologji e shpim pusesh.

Më 1975 u vu në funksionim kinoklubi i ri me dy kate, që u financua nga ndërmarrja minierës me sallë kinemaje dhe koncertesh me 350 vende, me bibliotekë e sallë leximi, bar-kafe dhe dhoma e anekse të tjera pune, duke u krijuar kështu mundësia që në këto ambiente të gjallëroheshin aktivitetet kulturore e artistike, sesionet shkencore, recensionet, bisedat etj.. Ky pallat është rikonstruktuar dhe vazhdon të jetë si qendër kulturore e vetme e këtij qyteti. Në vitin 1989 u ndërtua shkolla 8-vjeçare me 4 kate në "Lagjen e Re", me 24 klasa, 4 kabinete e palestër sportive.

FRAGMENTARIZIMI I MINIERËS NË KOMPANI KONCESIONARE

Bulqiza është një trevë, e cila shtrihet në pjesën verilindore të vendit dhe përfshihet në Qarkun e Dibrës. Jeta në këtë zonë zhvillohet në dy dimensione. Në të vërtetë janë dy Bulqiza, Bulqiza që shtrihet gjeografikisht dhe Bulqiza e nëntokës.. Miniera e dikurshme e centralizuar është fragmentarizuar në qindra kompani koncesionare. Sipas Ministrisë së Energetikës, deri në fund të 2015 kanë qenë aktive gjithsej 264 leje minerare shfrytëzimi për mineral kromi, nga të cilat tre leje janë koncesionare. Këto leje janë të shpërndara në 12 rrethe të vendit dhe në dy brezat e shkëmbinjve ultrabazikë.

Numri më i madh i lejeve të shfrytëzimit, mbi 150, ndodhet në rrethin e Bulqizës. Në vitin 2000 u firmos nga qeveria dhënia me koncesion e puseve të thellësisë të Bulqizës dhe të Fabrikës së Pasurimit të Kromit në Bulqizë dhe në Klos si dhe Uzinat e Ferrokromit në Burrel e Elbasan, për 30 vjet . Pas nëntë vitesh, në korrik të vitit 2009, "DARFO" i shet 100 % të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë koncesionare "DARFO ALBANIA", shoqërisë "ACR Holding" dhe pas kësaj, emri i shoqërisë ndryshohet në "Albanian Chrome" me të njëjtin NIPT. Më 17 janar 2013 "Balfin Group", me Samir Mane si drejtues i bleu aksionet e kompanisë "Albanian Chrome" (ACR), shoqërisë "DCM DECO-metal GmbH-DCM Beteiligungs GmbH. (BIRN). Por ndërsa premtoi një investim prej 55 milionë Euro për Pusin deri në vitin 2021, pikërisht në dhjetor të këtij viti Minierat në pronësinë e "Balfin Group", në Bulqizë i kalojnë në zotërim shoqërisë turke "Yildirim International Mining Investments B.V." Shtatëdhjetëepesë vjet pas krijimit, miniera e kromit Bulqizë nuk është më një ndërmarrje gjigande, por një sistem i tërë shfrytëzimi që ndahet në rreth 130 ndërmarrje private, gjeneruese të punësimit për shumicën e familjeve të zonës. Për këtë arsye ajo ka një rëndësi strategjike dhe duhet sjellë në vëmendje të qeverisë dhe të opinionit publik, pasi përbën një kantier të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare.

Me këtë fabrikë e kanë lidhur jetën e tyre rreth 100 familje nga qyteti i Bulqizës

intervista

BUKUROSH KOÇI: Në Fabrikën e Pasurimit të Kromit u investuan 5.2 milion dollarë

• Puna në këtë fabrikë që filloi në vitin 2011 na dha eksperiencën për një sipërmarrje tjetër në Kosovë me fabrikën e pasurimit të kromit në Devë, Gjakovë-Kosovë, me një kapacitet përpunimi 120 mijë ton dhe një vlerë investimi mbi 1.8 milion USD

Inxhinier Bukurosh Koçi, të cilit në vitin 1980 i refuzohej e drejta e studimeve të larta për "njolla në biografi" sot është ndër sipërmarrësit më të suksesshëm. Autori i disa studimeve të kryera për pasurimin dhe parapasurimin e mineraleve të kromit në zonën e Bulqizës, Batrës, Krastës, Tërrnovës, Kukësit, Tropojës, Hasit etj, si dhe bashkëpunëtor në kryerjen e disa studimeve nga Instituti i Studimeve të Teknologjisë së Mineraleve, Tiranë; po ashtu autor dhe bashkautor i ndërtimit të disa Fabrikave e impianteve për pasurimin e mineralit të kromeve të varfëra, si dhe i disa rikonstrukcione Fabrikash Pasurimi, ka ngritur e konsoliduar një Shoqëri nga e cila janë përpunuar dhe vazhdojnë të ripërpunohen mbi 2.5 milion ton sterile dambe, duke prodhuar koncentrat kromi për eksport. Sot në këtë shoqëri që po mbush afro 23 vjet, punojnë rreth 100 punonjës të profesioneve teknologë, mekanikë, elektrike, manovratorë e shoferë.

Në këtë intervistë ekskluzive për gazetën "Bulqiza", Bukurosh Koçi shprehet për përfshirjen më të gjerë të shoqërisë, jo vetëm në përpunim por dhe prodhim të lëndës së parë, qoftë dhe për kromite të varfëra, duke vërejtur se sasia e sterileve që mund të riciklohet po shkon drejt përfundimit, ndaj orientimit të ri të shoqërisë dhe drejt objekteve të reja të shfrytëzimit të kromit apo dhe kërkim-zbulimit të trupave të rinj minerare.

-Zoti Koçi, më 18 shkurt mbushen 75 vjet nga krijimi i minierës së kromit Bulqizë. Si një nga ekspertët dhe drejtuesit e Fabrikës së Pasurimit si e përjetoni këtë jubile?

Ky jubile është një ngjarje e veçantë që realisht më prek jo vetëm mua, por prek ndjenjat e shumë njerëzve që jetën e tyre dhe të familjeve e lidhën me këtë minierë. Miniera e Bulqizës me rezervat e saj unikalë ka bërë të njohur Shqipërinë në vite si vendi i trete në prodhimin nominal të kromit dhe vendi i parë në botë për prodhimin e kromit për frymë popullsisë.

Industria e mineralit të kromit me fillesat e saj prej viteve 40-të, me punën eksploruese të geologut Injac Gj. Ndojaj, që ka shkruar për kromin e Iballës, dhe shfrytëzimin nga italianët të vendburimit të Kalimashit, mori rolin si një nga degët bazë të ekonomisë shqiptare me zhvillimin e veprimtarisë minerare në Bulqizë në vitin 1948. Miniera e kromit "Todo Manço" në Bulqizë, që përfshin minierën e Bulqizës dhe një seri vendburimesh të tjerë, si Tërrnovë, Selishtë, Livadhi i Dashit, Pylli Zi, Qafë Lame, Qaf Bualli, etj, për gjithë këto 75 vite, ende sot mban peshën kryesore të industrisë së kromit në Shqipëri, duke prodhuar përgjatë këtyre viteve mbi 12 milion ton xehëror kromi. Fillesat e saj dhe aktiviteti i realizuar ndër vite janë kontribut i mijëra punonjësve, punëtorë, teknikë e inxhinierë, të cilët e lidhën pjesërisht ose përjetësisht jetën e tyre me këtë minierë.



Shqipëria megjithëse ka një sipërfaqe të vogël, është një nga vendet më të pasura me vendburime dhe shfaqje të kromit. Rezervat e kromit në Shqipëri për 285 vendburimet e vlerësuara, përllëgariten në 37 milion ton. Masivi i Bulqizës me një shtrirje prej 374 km², në raport me gjithë masivet e tjerë ka rezultuar masivi më përqëndrim më të mëdha të trupave minerare në shfrytëzim.

Duke qenë pjesë e kësaj historie për pothuaj 40 vite tashmë, si inxhinier, drejtues e sipërmarrës pranë Fabrikës së Pasurimit, më krijon efekt të veçantë duke më kthyer pas në vite në kujtime me fillesat e kësaj fabrike, si dhe të gjithë miqtë e shokët e mi ndër vite që kontribuan pranë kësaj fabrike si: Selaudin Shabani, Mirdash Dani, Sabri Troci, Sokol Mati, Pirro Zoga, Ramazan Sula, Shpëtim Lleshi, Gjergji Dishnica, Budjon Xhuti, Ferit Lala, Lloreni Kola, Rolanda Dervishi, Islam Nika, Ahmet Ckurti; Përgjegjësit e Fabrikës: Ismail Hida Isuf Kurti, Avni Kaltanji, Arif Jashari, Ylli Hoxha, Dalil Buci; Drejtuesit e laboratorit, ing. Zenepe Shehu, Perlat Sadikaj; teknikë: Ibrahim Dervishi, Haki Lami, Rihana Bode, Drita Perkola, Kujtime Koçi. Lume Teta, Zuliha Zuna, Fatime Bici, Sanije Stojku, Enverie Sejdini etj.

Fabrika e pasurimit të kromit në Bulqizë është vënë në punë në vitet 1971-1972 për përpunimin e pasurimit të mineraleve të varfëra të kromit, të çakellit e pluhrave që dalin pas impianteve të seleksionimit e fraksionimit në minierat e zonës Bulqizë -Bater. Fabrika ka një kapacitet maksimal përpunimi deri në 240.000 ton në vit. Në vitet e fundit ka shërbyer gjithashtu, si objekt riciklues i sterileve të mëparshme të cilat janë përdorur si lëndë e parë sekondare për këtë fabrikë. Pranë kësaj fabrike kanë dhënë kontribut mbi 1200 punonjës, dhjetra inxhinierë teknologë, kimistë, mekanikë, elektrik, ndërtimi, etj, pjesë e ndërmarrjes minerare Bulqizë, por dhe të Insti-

tutit të Teknologjisë së Nxjerrjes dhe Përpunimit të Mineraleve (ISPTM).

Prej vitit 2001 Fabrika drejtohet nga ing. Bukurosh Koçi - Administrator. Gjithashtu punojnë: ing. Islam Nika, financierë: Munir Konesha, Gerta Koxha, e Aqif Lasku, teknikë: Mustafa Kajnozi e Naim Kajnozi si dhe përgjegjës transporti Bardhul Gjimi. Një kontribut të veçantë kanë dhënë edhe specialistët energomekanik si: Shefqet Duriçi, Mustafa Kajnozi, Naim Kajnozi, Bashkim Duriçi, Sazan Bajrami, Luan Gjimi, Rrushdi Koçi, Zenel Prejsi, Dylber Llorja, Almir Dufi, Fatos Llani, Gazmir Tyçi, Lirim Fiku; teknologët: Nazmi Lika, Kasem Dervishi, Marjanta Duriçi, Sabri Koçi, Mustafa Kamishi, Ramazan Duriçi, Majlinda Duriçi, Dafina Dedja, Fatime Hupi, Mite Dervishi, Milita Nika, Lirie Hoxha, Shpëtim Hoxha, Ilmi Alla, Arben Cami, Ledio Koçi, Sidorela Koçi, Shqipe Koçi, Shazimete Kazani, Shqipe Keta, Hatixhe Basha, Mimoza Zogu, Farie Osmani, Anila Hasbajrami etj. Gjithashtu kanë dhënë kontribut manovratorët dhe shoferët: Bajram Cani, Ylli Duriçi, Petrit Koçi, Besim Duriçi, Eduart Pupa, Ramiz Qoku, Eduart Kamishi, Lutfi Llani, Kadri Koçi, Agim Pepa, Mufail Mazari, Agron Jashari, Bujar Llaka, etj.

-FABRIKA që ju menaxhoni është ndër sipërmarrjet private më të suksesshme. Konkretisht një bilanc të saj?

Fabrika e pasurimit të Bulqizë, pas kolapsit të industrisë minerare të viteve 1991 arriti të mbijetonte dhe disa vite më pas. Si shumica e objekteve minerare të shfrytëzimit dhe përpunimit kaloi në konservim. Përgjatë këtyre viteve që prej vitit 1985, unë kam qenë pjesë e saj si inxhinier dhe drejtues. Kjo fabrikë rifilloi punë kur unë si sipërmarrës pas vitit 2001, si shoqëri nënkontraktore e konçesionit të Bulqizës mora përsipër rikonstrukcionin dhe rivënie në punë të saj, fillimisht me kapacitete të reduktuara dhe më vonë në kapacitet të plotë. Puna dhe shfrytëzimi i

fitimeve të krijuara prej saj ndër vite garantuan investimin pranë kësaj fabrike në vlerë prej pothuaj 5.2 milion USD. Ky investim bëri që aktualisht fabrika të ketë një kapacitet përpunues prej 260 mijë ton në vit, dhe një prodhim vjetor rreth 18 mijë ton në vit koncentrat kromi me një përmbajtje 39-40 % Cr₂O₃. Me këtë fabrikë e kanë lidhur jetën e tyre rreth 100 familje nga qyteti i Bulqizës duke qenë punëdhënësi për 100 persona aktualisht.

Puna në këtë fabrikë që filloi në vitin 2011 na dha eksperiencën për një sipërmarrje tjetër në Kosovë me fabrikën e pasurimit të kromit në Devë, Gjakovë-Kosovë, me një kapacitet përpunimi 120 mijë ton dhe një vlerë investimi mbi 1.8 milion USD.

Më pas, në vitin 2017 u realizua një investim i ri në Kalimash për ndërtimin e një fabrike të re pasurimi kromi, me një skemë teknologjike të avancuar si në aspektin e teknologjisë së aplikuar por dhe të pajisjeve të përdorura për një kapacitet përpunues 100 mijë ton në vit me një vlerë investimi që i kalon 2.5 milion USD.

Me të tre këto objekte përpunues, shoqëria jonë aktualisht është prodhuesi kryesor i produkteve të përpunuara të kromit (koncentrat kromi të cilësive të ndryshme), me një treg në Europë dhe global (Francë, Bullgari, Itali, Hollandë, Kinë).

-Cili është synimi juaj për të ardhmen?

Në kuadrin e sfidave të ndryshme që industria minerare po përballet globalisht synimet tona në të ardhmen janë drejtuar fillimisht në:

1. Uljen e kostos së prodhimit. Në këtë kuadër elementi i kostos "energjia elektrike" na bëri që të orientojmë investimin në afatshkurt tek fabrika e Bulqizës, tek mbulimi në masën 33%-50% të kërkesës për energji të saj, nëpërmjet instalimit të paneleve diellore mbi çatitë e kësaj fabrike, me një kapacitet 1 MW, një investim mbi 700 mijë Euro që do të vihet në efektivitet të plotë këtë vit.

2. Përmirësimet teknologjike, si në skemën e trajtimit të xehërorit ashtu dhe në rinovim pajisjesh teknologjike në një vlerë mbi 200 mijë USD.

3. Për futjen e teknologjive të reja për pasurimin e xehërorëve të kromit është dhe ndërtimi i një linje të re për parapasurimin e mineraleve të varfëra të kromit, e cila do të përfshijë një skemë të plotë për parapasurimin e kromiteve të varfëra me një investim prej më shumë se 320 mijë Euro; një skemë që ka rezultuar efektive pranë fabrikës së Kalimashit për Kromitet e varfëra të masivit të Kalimashit.

4. Përfshirjen më të gjerë të shoqërisë, jo vetëm në përpunim por dhe prodhim të lëndës së parë, qoftë dhe për kromite të varfëra, duke vërejtur se sasia e sterileve që mund të riciklohet po shkon drejt përfundimit, ndaj orientimit të ri të shoqërisë dhe drejt objekteve të reja të shfrytëzimit të kromit apo dhe kërkim-zbulimit të trupave të rinj minerare.

5. Po ashtu një punë për rritjen profesionale të nxënësve dhe krijimin e mundësive për t'u përfshirë në bizneset e kromit në Bulqizë dhe jo vetëm, në Kalimash, has, Tropojë por dhe në Kosovë.

Intervistoi: Halil RAMA

Rrugëtimi i suksesshëm i Ing. Bukurosh Koçit

NERTILA CEKA

Inzhinier Bukurosh Koçi, që vitet e sistemit monist mezi kapërceu pengesat e të qënurit bir i një familje të dekluar, me profesionalizëm e përkushtim të rallë ka arritur të krijojë e konsolidojë një shoqëri që sot ka në shfrytëzim 6 leje minerare, si dhe një personel të kënaqshëm inzhinier - teknik e ekonomistë. Nga puna në këto 23 vite kanë dalë në pension dhe disa punonjës, të cilët, po të mos ishte vënë në punë kjo Fabrikë nuk do dilnin në pension të plotë.

Po kush është ky sipërmarrës, ndër më të suksesshmit në rang kombëtar?

Pas kryerjes së shkollës 8 vjeçare me nota të shkëlqyera, Bukurosh Koçi, si gjithë bashkëmohatarët e tij ka kërkuar të vazhdojë studimet në një nga degët e preferuara si elektrike, mekanike, kimi industriale etj. Por për arsye biografike i është refuzuar kjo e drejtë, me pretendimin absurd se kishte babain të përjashtuar nga Partia e Punës në vitin 1962, gjyshin të dënuar politikisht e dajat e babait të cilesuar si kulak.

Kështu në vitin 1975-1976 ka vazhduar shkollën e mesme, dega minierë në Bulqizë. Pasi mbaroi vitin e parë, dega miniera, ende nuk i ishin shuar shpresat që të studioje në një nga degët që dëshiron. Në vitin 1976, nisur dhe nga dëshira për të punuar dhe vazhduar studimet në degën elektrike, ka vazhduar studimet pa shpërndarje nga puna në Shkollën e Mesme Elektrike në Fierzë, nga viti i II-të deri në vitin e IV-t, të cilën e mbaroi me nota të shkëlqyera.

Pas mbarimit të shkollës së mesme dhe disa kualifikimeve profesionale, si elektrikist, elektroaut, hidraulik etj, Bukurosh Koçi (i cili kishte lindur në Ulëz -Mat më 02.09.1960) kërkoi të studiojë në Universitetin Shtetëror të Tiranës, dega elektrike. Por përsëri, për arsye biografike, megjithëse në një situatë tjetër më të zbutur, nuk ju dha e drejta për asnjë degë të Universitetit të Tiranës.

Punoi dhe një vit si elektrikist në Ndërmarrjen Ndërtim Miniera në Bulqizë dhe në vitin 1981 iu dha e drejta për të vazhduar studimet në fakultetin e Gjeologji - Miniera,



- Në shtator 2001 mori kontratën nga kompania "Darfo Italia Spa" si nënkontraktor, ku sipas kontratës duhej të bëhej studimi dhe projekti i vënies në punë të fabrikës, si dhe duheshin kryer investime në përputhje me marrëveshjen koncesionare tip R O T, gjetjen e tregut si dhe porositjen e makinerive e paisjeve, pjesëve teknologjike etj. U bënë studime dhe projekte si dhe u porositën makineri e pajisje teknologjike që kapin vlerën e afro 5 milionë dollarëve. Gjatë 15 viteve të para, u futën në pasurim stogjet e varfëra minerale, si dhe u hapën me dhjetra miniera të reja e të vjetra për prodhimin e mineralit të kromit, për t'u paturuar më tej në fabrikë

dega Pasurim Mineralesh.

Në vitin 1985, pasi mbaroi studimet dhe u diplomua si inzhinier pasurimi, emërohet inzhinier pasurimi turni në Fabrikën e Pasurimit të Kromit Bulqizë, ku ka punuar pothuajse në të gjitha repartet si inzhinier teknolog turni, inzhinier në degën e prodhimit, degën teknike, degën e sasi - cilësisë etj.

Në vitin 1987 është emëruar kryetknolog pranë kësaj fabrike.

Në vitin 1988 shkoi për specializim në Gjermani. Është autor i disa studimeve të kryera për pasurimin dhe parapasurimin e mineraleve të kromit në zonën e Bul-

qizës, Batrës, Krastës, Tërrnovës, Kukësit, Tropojës, Hasit etj, si dhe bashkpunëtor në kryerjen e disa studimeve nga Instituti i Studimeve të Teknologjisë së Mineraleve, Tiranë.

Po ashtu, Ing. Bukurosh Koçi është autor dhe bashkautor i ndërtimit të disa fabrikave e impianteve për pasurimin e mineralit të kromeve të varfëra, si dhe i disa rikonstruksione Fabrikash Pasurimi. Ka marrë pjesë dhe ka referuar në disa kongrese pasurimi mineralesh ballkanike e ndërkombëtare në fushën e industrisë Minerare të Pasurimit, të zhvilluara në Shqipëri, Turqi, Serbi, Francë, Kinë, Amerikë, etj. Në vitin 1992, si rezultat i mbylljes së aktivitetit të fabrikës së Pasurimit të Kromit, për shkak të ndërrimit të sistemit, rënies së konjunkturës së kromit në tregun botëror, si dhe mbylljes së aktivitetit të Pasurimit në Bulqizë, mbeti i papunë. Në këto kushte u detyrua të kryejë punë të ndryshme në sektorë private, jashtë profesionit.

Në vitin 1996 ka rifilluar në Fabrikën e Pasurimit të Kromit si Inzhinier, ku tashmë kishin mbetur vetëm muret e dëmtuara dhe emri i vjetër i fabrikës, pasi gjendja teknike e teknologjike ishte shumë e rëndë, e shkatërruar totalisht, ku fabrika kishte marrë pamjen e një gërmadhe. Ndoshta do të kishte pësuar fatin e Fabrikave të Pasurimit të Kromit në Krastë - Martanesh, Kalimash - Kukës, apo Fabrikave të pasurimit të hekurit në Pogradec, Fabrikave të Pasurimit të Bakrit në Kurbnesh, Reps, Rrëshen, Fabrikës së pasurimit të Qymyrit në Valias, Uzinave të Bakrit në Rubik, Superfosfatit në Laç etj.

Rifillimi i punës u pa si një shpresë e

madhe për një grup punonjësish për të fituar bukën e gojës dhe për të mbajtur afërsisht 150 familje, e për të shkolluar fëmijët e tyre.

Me një përgjegjësi të madhe, në kushte tepër të vështira, Ing. Bukurosh Koçi mori përsipër të ringrejë të paktën një linjë pasurimi, tashmë jo për pasurim minerali por skorje ferrokromi. Kështu, në bashkëpunim me disa kolegë e specialistë me përvojë dhe me mbi 15 vite pune në këtë fabrikë, studiuam mundësinë e riaktivizimit të kësaj fabrike, tashmë jo me mineral kromi por duke përpunuar skorje të Ferrokromit nga Uzina e Ferrokromit Burrel.

Pas një pune këmbëngulese arriti të projektojë e zbatojë një linjë pasurimi për skorjet e mbetura nga Uzina e Ferrokromit në Burrel, në kushtet aktuale të Fabrikës ekzistuese. Ndërkohë, brenda një periudhe 5-6 mujore vuri në punë me sukses këtë linjë. Si rezultat u punësuan rreth 150 punonjës teknolog si dhe u futën në përpunim skorjet e depozituara si mbetje pranë Uzinës së Ferrokromit në Burrel, duke prodhuar ferrokrom pluhur, i cili kërkohet në tregun ndërkombëtar.

Po në vitin 1996, B. Koçi emërohet zv/ Drejtor i Minierës së Kromit Bulqizë, si dhe Përgjegjës i Fabrikës së Pasurimit të Kromit Bulqizë.

Në vitin 1998 është emëruar Drejtor i Parkut të Transportit të Kromit në Bulqizë, detyrë të cilën e ka kryer me kompetencë e përkushtim të rallë deri në vitin 2000. Madje në këtë ndërmarrje, megjithëse e mori drejtimin e saj në një gjendje të keqe dhe jashtë kontrollit, arriti që të vendosë në efikasitet të plotë të gjithë parkun me të gjitha mjetet e transportit të mallrave e punëtorëve, duke përballuar me sukses transportin e mineralit për në Burrel, Elbasan, Durrës etj, si dhe transportin e punëtorëve në zonën e Bulqizës.

Në vitin 2000 deri në vitin 2001 është transferuar në ALBKROM në Tiranë, ku ka punuar specialist pranë kompanisë deri në privatizimin me koncesion të Albkromit. Në shtator 2001 mori kontratën nga kompania "Darfo Italia Spa" si nënkontraktor, ku sipas kontratës duhej të bëhej studimi dhe projekti i vënies në punë të fabrikës. Ndërkohë duheshin kryer investime në përputhje me marrëveshjen koncesionare tip R O T, gjetjen e tregut si dhe porositjen e makinerive e paisjeve, pjesëve teknologjike etj. U bënë studime dhe projekte si dhe u porositën makineri e pajisje teknologjike që kapin vlerën e afro 5 milionë dollarëve. Gjatë 15 viteve të para u futën në pasurim stogjet e varfëra minerale, si dhe u hapën me dhjetra miniera të reja e të vjetra për prodhimin e mineralit të kromit, për t'u pasuruar më tej në fabrikë. U përpunuan e vazhdojnë të ripërpunohen mbi 2.5 milion ton sterile dambe duke prodhuar koncentrat kromi për eksport.

Sot në këtë shoqëri që po mbush afro 23 vjet, punojnë rreth 100 punonjës të profesioneve teknologjike, mekanikë, elektrike, manovratorë e shoferë.

Kjo shoqëri aktualisht ka në shfrytëzim 6 leje minerare, si dhe një personel të kënaqshëm inzhinier - teknik e ekonomistë. Nga puna këto 23 vite kanë dalë në pension dhe disa punonjës, të cilët, po të mos ishte vënë në punë kjo Fabrikë nuk do dilnin në pension të plotë.



MBRESA NGA DARDANIA

Në drekën e organizuar në "Çarshija e Jupave", surprizë ishte dhënia e disa çertifikatave "Nderi i Shoqates Bulqiza" për njerëz të shquar, aktivistë bulqizakë: prof.dr. Islam Dauti; dr. Ajet Xhafa; dr. Hajri Mandri; dr.Jashar Demiri; ing.Sefedin Shabani dhe biznesmeni i suksesshëm Ing.Bukurosh Koçi

ERSILA BRUÇI

Kryesia e "Shoqatës Bulqiza" para pak ditësh bëri një eskursion në Dardani. Në ditën e parë udhëtuam Tiranë- Reps- Kalimash- Prizren- Kruhë e Madhe -Gjakovë. Vizituam fabrikën Eurochrome sh.p.k Kalimash, i nvestim i bulqizakut Bukurosh Koçi, ku menaxher është i ng. Dorian Voka. i nvestim mbreslënës me teknologji bashkëkohore për pasurimin e kromeve të varfëra.

Në qytetin historik të Prizrenit vizituam "Lidhja Shqiptare e Prizrenit", ku më 10 qershor 1878 u mblodhën përfaqësues nga paria shqiptare e Vilajetit të Kosovës në xhaminë Bajraklie për të ngritur një platformë si kundërpërgjigje ndaj vendimeve të marra në Traktatin e Shën Stefanit. Në mbledhjen e parisë më 18 qershor u radhitën qëndrimet e mbajtura në një shkresë të vendimeve quajtur Kararnamë, që u firmos nga 47 përfaqësues të kazave të vilajetit, ku në krye janë firmat e i Ijaz pashë Dibrës dhe Abdulla pashë Drenit. Në Kararnamë flitej për tërësinë territoriale të perandorisë Delekatët ngritën një organizim, Lidhjen e Prizrenit, që kishte fuqinë të vendoste taksa dhe të mobilizonte një ushtri. Lidhja u organizua në tre komitete, për Punët e Jashtme, për të Brendshmet dhe për Financat.

"KOPERATIVA BUJQESORE - KRUSHA", KU PUNOJNË GRATË E DËSHMORËVE TË KRUSHËS

Vazhduam vizitën mbreslënëse në "Koperativa Bujqesore - Krusha", ku menaxherja Farie Hoti na shpjegoi me emocion ngritjen e këtij aktiviteti, ku punojnë sot 50 gra të veja, që u janë



vrarë burrat dhe shumë të afërm nga serbët në vitin 1999. Gjatë vizitës këtu u njohëm me arritjet e këtij kooperimi, llojet e prodhimeve për përpunimin e specit e zarzivateve të tjera dhe suketet në treg ku shitja e prodhimeve i shte 100 %. Në bisedë aty na njohëm me mbështetjen që ju ka dhënë z. Qemal Minxhozi për ngritjen e këtij biznesi.

ME NE NË GJAKOVË EDHE AMBASADORI QEMAL MINXHOZI

Në Gjakovë ekipit tonë i u bashkuan Ambasadori i Republikës Shqipërisë në Kosovë z. Qemal Minxhozi dhe Dr. Ajet Xhafa, djalë bulqizak i suksesshëm në fushën e mjeksisë. Në drekën e organizuar në "Çarshija e Jupave", surprizë i shte dhënia e disa çertifikatave "Nderi i Shoqates Bulqiza" për njerëz të shquar aktivistë bulqizakë, prof.dr. Islam Dauti; dr. Ajet Xhafa; dr. Hajri

Mandri; dr.Jashar Demiri; ing.Sefedin Shabani; dhe biznesmeni i ng.Bukurosh Koçi. Mbasdite vizituam "Fabrikën e pasurimit të kromit në Devë", ku biznesmeni bulqizak Bukurosh Koci na njohu me punën në këtë fabrikë bashkëkohore të vendosur vetëm 6 km afër Gjakovës. Fabrika ka qenë e djegur krejtësisht dhe është rindërtuar e vënë në funksionim duke zbatuar teknologji të përparuar bashkëkohore.

NATYRA E VIRGJËR, ATY KU BURON UJI I DRINIT TË BARDHË

Në ditën e dytë vizitat vazhduam në drejtim të Deçanit e Pejës, ku ndaluan në resortin turistik të burimit të Drinit të Bardhë. Natyra e virgjër, ujrat e kthjellët, freskia e gjelbrimit i shin relaksuese për vizitorët e shumë nga trevat shqiptare e të huaj. i shte e veçantë vendi ku fillonte të buronte

uji i kristaltë i lumit Drini i Bardhë, dhe shpella mijëra vjeçare e Radavcit, që mbrohej me ligj nga viti 1983.

NË PREKAZIN HISTORIK KU PREHEN LUFTËTARËT E LIRISË TË FAMILJES JASHARI

Vizita vazhdoi në Prekaz, ku u njohëm me masakrën famëkeqe mbi Prekaz të njësisë speciale të Serbisë me 5 mars 1998, mbi familjen e Jasharajve në përpjekje për të kapur ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Në këtë operacion udhëheqësi i UÇK-së Adem Jashari, vëlly i tij Hamzë Jashari dhe 58 anëtarë të familjes Jashari ranë për lirinë e Kosovës. Vizita tek muzeu, busti i Adem Jasharit, shtëpitë e ruajtura në gjendjen që i la lufta ku humbën jetën 58 anëtarë të kësaj familje që prehen në varrezën e dëshmorëve të lirisë në Prekaz, të lenë emocione të dhimbshme kur kujton se sa e shtrenjtë është LIRIA.

TAKIMI ME MJEKUN E SUKSESSHËM DR. AJET XHAFI

Në Prishtinë u pritëm nga mjeku i talentuar bulqizak, dr. Ajet Xhafa, i cili na njohu me përpjekjet e tij të vazhdueshme për ngritjen në një nivel të lartë bashkëkohor kryerjen e operacioneve të urologjisë në Spitalin Amerikan në Prishtinë ku ai punon prej 10 vitesh. Duke rrugëtuar nëpër Dardani arrin të shohësh bukuritë e rralla natyrore por edhe përpjekjet mbreslënëse njerzore për zhvillimin në çdo cep në fshat e në qytet. Përfunduan vizitën duke u ndjerë të lumtur për Dardaninë tone, që e pamë në rrugën e drejtë të zhvillimit e të ngritjes së mirëqenies.

Historia me minierën e Bulqizës

(Vijon nga faqja 1)

E pra, një histori e tillë, natyrisht e imagjinuar, e futi Bulqizën në hartën e vendeve, me interes për pasurinë e saj, që në rrjedhën e viteve do ta ngjiste atë deri tek vendi i gjashtë në botë për prodhimin e përgjithshëm të mineralit të kromit dhe, thuhet madje, edhe në vendin e parë në prodhimin për frymë popullsi. Po çfarë ndodhi me kromin nga viti 1918 deri në vitin 1945? Historia për këtë periudhë ka fare pak kujtesë. Informacioni që merret ka të bëjë më disa qindra ton mineral të mblodhur direkt nga sipërfaqja, ku ishte dalja e tij, dhe transportimi i tyre me mushka deri në.... Ama interesi, sidomos tek italianët, ishte i veçantë. Ata planifikuan dhe ndërtuan rrugën Bulqizë-Peshkopi. Pra, në planet e tyre kromi

që do nxirrej nga Bulqiza, duhej të transportohej për në Itali dhe të futej kështu në tregun botëror të mineraleve me vlerë. Këto plane i prishi lufta.

Dhe vijmë tek viti 1948. Në këtë kohë, në Tiranë, kryesisht me ndihmën e aleatëve, u hartuan plane për hapjen e minierës së Bulqizës. E, pikërisht, më 18 shkurt 1948, tek "Ahishta e Madhe" u dëgjua shpërthimi i minave të para. Punëtorët që e kryen këtë shpërthim ishin punëtorë (minatorë), që kishin ardhë në Bulqizë nga miniera e Rubikut. Po ishin edhe vendas si Osman Losha, Tosum Spahiu, Myrteza Duriçi etj të cilët njihen si punëtorët e parë të minierës. Pikërisht, në sajë të këtij aktiviteti, por edhe të mosndërprerjes së tij gjatë gjithë kohës deri në ditën e sotme, data 18 shkurt 1948 ka hyrë në histori si dita e lindjes së minierës së kromit në Bulqizë.

portret

Populli, e përjetësoj në memorien e vet djalin e saj, Isuf Koçi. Edhe sot, në oda burrash, pohohet: Djalë si ai, nuk i vjen më Bulqizës!

Populli, e përjetësoj në memorien e vet djalin e saj, Isuf Koçi. Edhe sot, në oda burrash, pohohet: Djalë si ai, nuk i vjen më Bulqizës!

Po. Ai ishte dhe mbetet simbol i vlerave më të mira njerëzore dhe intelektuale, mishërues dhe përçues i mençurisë dhe urtësisë dibrane. Këto virtyte e shoqëruan si kuadër e drejtues shembullor, qoftë në ish-kooperativën bujqësore dhe në fermën e Fushë Bulqizës të cilën e drejtoi me kompetencë e profesionalizëm deri në fundin e sistemit monist. Kur drejtonte Isuf Koçi, kooperativa dhe ferma patën nivelin më të lartë të zhvillimit të të gjitha kohërave.

* * *

Befasuese, është praktika shkretore në AQSH, tepër e ngjeshur dhe me mendimekontraditore, kur do krijohej sektor ferme në Bulqizë, në formë hozrashoti. Ndonëse Bulqiza ishte 30 vjet kooperativë dhe propozohej për fermë (150 ha), të gjithëshpreheshin kundër, me justifikim objektiv: Bulqiza nuk ka kushte! Dhe këtë e thoshin Ministria e Bujqësisë, Financave, Komisioni i Planit të Shtetit, këshilltari ikayeministrit, Zëvendëskryeministri! (AQSH, F 898, v.1977, d 97, fq 1-15, dixh.147) Pikërisht këtu, del kontributi i papërsëritshëm shkencor, profesional dhe qytetar i Isuf Koçit,që ai, të bënte atë që kish në dorë, në profesionin e vet, që nuk ja lëshonte rrugë cilitdo.Ç'bëri? Nxorri nga arkivi personal gjithë studimet që kishte bërë në vite, në bashkëpunim me institutet kërkimore shkencore, ku ai ishte protagonist, si: Klasifikimi hidrologjik i Fushës së Vajkalit dhe ndikimi i ujrave nëntokësore në të; Rezervatujore në bazenat ujëmbledhëse të liqeneve poshtë Dhoksit dhe shfrytëzimi i tyre në dobi tëVajkalit, që duke ngritur një kolektor në kodër Alle dhe me rrjedhje të lirë vadijetej gjithëVajkali, pa kufizim; Ndikimet në mjedis, etj. Ishte kjo punë e heshtur e Isuf Koçit, që do ikthente të gjithë tek logjika shkencore dhe njerëzore: - Nuk duhet të ketë studime dhepraktika zhvillimi në zonat ekstremisht të vështira, siç vlerësohej Bulqiza. Ku qëndronte qortueshmëria në studimet, shoqëruar me propozimin që ai paraqiste?Pastaj, do i shtangte të gjithë me deduksione shkencore alternative, të kryqëzuara me studime“makro ekonomike”, duke përdorë metodën studimore “krahasuese”, për raste të ngjashmeme Bulqizën.Nëse, jo siç thoshte Isuf Koçi, por siç thonin gjithë dikasteret kundër tij, natyrshëm lindtepyetja? Nëse 30 vjet, kooperativa jorentabële, ç'farë u korrigjua?Ministria e Bujqësisë do i shprehej kryeministrit Mehmet Shehu, kur diskutohet për fermë, seBulqiza, nuk kishte kushte për prodhim fruta-perime, por Isuf Koçi, do i sfidonte të gjithë. Dotë bënte të pabesueshmen me argument “gozhdë trau”, që vështirë të thojë jo. Se Bulqiza, përherë të parë, në shekuj, kishte teprica në perime, mbi nevojat e veta, dhe Isuf Koçi, kishtehapur pika shitje tepricash, në qytet.

Bujqësia, është si miniera, që kërkon punime kërkimore, nëse tentonmineralin

Ishte dalluar që kur vazhdonte studimet në Institutin Bujqësor të Kamzës

ISUF KOÇI

PROFILI I INTELEKTUALIT DHE DREJTUESIT TË SHQUAR NË SEKTORIN E BUJQËSISË



kishte kapaciteteshkencore. Studentët me rezultate të larta këtu i mbanin shumë afër. I aktivizonin në kërkimemodeste shkencore. Dhe studenti Isuf Koçi do ishte një ndër ta. Porasia ndaj studentëve të dalluar, ishte: -Shkolla të hap vetëm një dritare. Jeta, është “fusha e luftës” që provon cilësitë e secilit. Po undave nga libri me mendësinë se mbaruam shkollën, keni vdekur. Bujqësia, është si miniera,që kërkon punime kërkimore, nëse tenton mineralin.

Tregonte Isuf Koçi:

Ditën që mora emërimin për Bulqizë, pedagogu që kisha për zemër, më thotë:- Isuf! Ashtu siç nuk ka të mira absolute, nuk ka as të këqia absolute. Ti, ke shansin se, përzonen e Bulqizës, nuk ka studime. Me mendësinë se Bulqiza është e vështirë dhe studimetjanë pa leverdi ka mbetur fushë e pashkelur. Nuk ka asnjë studim të thelluar për të, mepërjashtim të studimit të tharjes së Fushës së Vajkalit. Të bësh punë të dobishme përBulqizën, në fushën e bujqësisë, do të thotë të kërkosh mundësi zgjidhje edhe në kushtet esaj. Bulqiza, e studjuar në aspektin shkencor të mundësive, mund të jetë rast i veçantë. Dhenë kushte ekstremisht të vështira, kur gjen një zgjidhje të ndërmjetme, sukseesi është dy herëmë i madh. Pra përpiqu të bëhesh pjesë e kësaj përpjekje. Ani se në dukje modeste por, dombetesh në kujtesë, nëse do të lësh gjurmë. Se njerzit, mbajnë mend vetëm të veçantat dhendryshimet që sjell, jo punët që i bëjnë të gjithë, me instiktet e përvojës rutinë.Mbas kësaj bisede, pedagogu, i kishte garantuar: Laboratorët e Institutit do t'i keshë nëdispozicion. Por dhe të insitututeve, ku kam miqtë dhe bashkëpunërorët do i kesh krah. Por ti,ke rolin kyç në Bulqizën si rast i veçantë.Absolutisht rast i veçantë por

ideale për studime komplekse. Se ti je aty ku lind problemi. Iprek gjithçka me dorë. I sheh me sy. I eksperimenton, po ti. Kjo, ka shumë rëndësi! Ndaj, tëlutem: Po bëre këtë, suksesin do e kesh të garantuar, edhe në Bulqizën shumë të vështirë. Dhe vërtetë, bazuar në studimet efikase të Isuf Koçit, siç del nga arkivat e kohës, Qeveria,shkroi:

Projekt Vendim: Ministria e Bujqësisë, dërguar Këshillit të Ministrave dhe disa ministrave “mbi kalimin e 150ha tokë arë nga Kooperativa Bujqësore Bulqizë, në përdorim të NB-së Dibër (AQSH, fondi498, viti 1977, dosja 97, araka 135, dixh. 147).Ishin këto arsye të kishim befasinë tjetër të radhës: Në Bulqizën e vështirë do kishim sektorferme, kur fermat në shkallë Republike numëroheshin me gishtat e dorës! Kjo falë këmbënguljes së Isuf Koçit dhe një fjalës së mbajtur prej Mehmet Shehut përpunësimin e 100 grave të minatorëve në fermë! Dhe kaq mjaftoi që ferma të krijohej, edhepse ishin gjithë dikasteret kundër! Por Bulqiza fitoi. Isuf Koçi, fitoi!

PSE PRESONALITETI I ISUF KOÇIT MERITON STUDIUM?

Se ai, edhe në Bulqizën ekstremisht të vështirë, bëri punë të mëdha në raport me kufizimet ekohës dhe mjedisit.Kur të gjithë kundërshtonin, ai mbronte idetë e veta me studime efektiviteti, sipas parimit “tëkeqes më të vogël”. Kjo, i vuri vulën përfundimit: Ferma ishte e nevojshme dhe e justifikueshme, ndonëse jo gjithnjë e për çdo artikull mund të ishte rentabël.

Ishte pikërisht, shtrirja e treguesve të efektivitetit përtej koston për njësi, që do realizontepërmbysjen për mirë. “Afërsia e konsumatorit minierë”, ishte çelësi magjik që bindi dhe më të pabindurit, që ferma indirekt të dilte përsëri efektive, në analizën komplekse” makro”. Ishtekëmbëngulja e hekurt e Isufit

me shokë, që e çoj natyrshëm tek zgjidhja në favor tëbulqizakëve.Me laps, grupi punës do argumentonte: Nëse domatja do kushtojë një lek më shumë nëshpenzime prodhimi në raport me Lushnjën, sa fitojmë nga diferenca e transportit tëdomateve nga Lushnja në Bulqizë? Po cilësia e prodhimit të freskët? Po mundësia eplotësisimit të nevojave në çdo kohë? Duke qenë prodhimi afër minierës konsumatore,avantazhet ishin pa fund. Mbi të gjitha, mbyllej dhe një ankesë publike, e paqortueshme nëpërmbytje, edhe se ankimet, sidomos në grup, ishin thellësisht të dënueshme për sistemin ekohës. Por, a mund të shpallehin armiq tre autobuza me punëtorë? Ja pse, tani mbas më shumë se tri dekadave, kemi arsye vlerësimi të disa lëvizjeve të zgjuaratë bulqizakëve, në interes të komuntetit. Ashtu si, në vitet ‘50 të, kur ende miniera ndriçohejme motorë me naftë, Vajkali, në sajë të burrave: Kamber Duriçi dhe Mexhit Shehu,sensibilizuan qeverinë, që Vajkali, të kishte dritë elektike ndër fshtrat e para në Shqipëri. DheBulqiza e meritonte se nxirrte krom. Se në zabelet e Bulqizës, që bulqizakët i kishin si “arëbuke” dhe shiteshin, blisheshin dhe trashëgoheshin si arë buke, sot, bulqizakët nuk i lënë as tëmbledhin sterilet e kromit që i mbajtën 50 vjet mbi supe, në tokën e tyre!Se nuk ka burra që t'i dalin zot vendit të vet, siç kishim Isuf Koçin, që rastësia e bëriagronom; që edhe se punoi në Bulqizën e vështirë për kjamet, ai la në pavdekësi personalitetine vet.

* * *

Sot nuk e kemi më Isuf Koçin. Ai ka marrë rrugën për në parajsë. Por, nëse do perifrasonimNaim Frashërin, bektashi, ku dhe Isufi besoi, këtu mund të gjenim arsyen për pak qetësi:“Ndoshta, Zoti e desh i afër vetes këtë Njeri”.

A.KETA

Për librin e studjuesit Bashkim Lami
"Qëndresa e bulqizakëve në luftërat
për liri"

analiza

"Testament" historie që na njeh me luftën e madhe kundër serbëve në vitet 1912-1921

NGA DR. ADRIATIK BALLA

Sikurse të gjitha zonat e Dibrës, Bulqiza ishte në frontin e luftës 9-vjeçare me krahjet, kryesisht serbët, midis viteve 1912 dhe 1921. Kudo e kurdoherë, populli i kësaj zone shfaqet me të gjithë madhësinë e vet në llogore për të ruajtur, siç e thotë plot emocion në letrën e tij komandanti i trupave qeveritare në qafë Buall, Ali Rizai, "emnin e hymnueshëm shqiptar". Autori Bashkim Lami, i lindur në Vajkal në vitin 1947, me profesion arsimtar, por njëherësh kuadër e intelektual, si dhe organizator e drejtues i shoqatës kulturore e atdhetare "Bulqiza", botoi një vit më parë librin e tij historik, "Qëndresa e bulqizakëve në luftërat për liri", me parathënie nga Prof. Asoc. dr. Bernard Zotaj, me fokus zhvillimet e dy shekujve të fundit në trevën e Bulqizës. "Kam jetuar shumë kohë me ndjenjën e përgjegjësishë, - thotë autori, - për të pasqyruar sakrificat dhe heroizmin në vendlindjen time, në kujtim të përpjekjeve mbinjerëzore të luftëtarëve bulqizakë, përkrah luftëtarëve dibranë në luftën për liri".

Dhe autori ia ka dalë mrekullisht, jo vetëm ta përmbledhë studimin e tij në një libër, por t'u lënë bulqizakëve një "testament", ku secili të përfitojë informacionin e duhur të historisë së tij e të familjes së tij, të fisit e të krahinës. Ashtu si Barleti që shkruan Historinë e Skënderbeut me fakte literature e arkive por edhe nga fjala e burrave të besës, ngjashëm dhe Bashkim Lami, ka monitoruar arkivat dhe dokumentet, por njëherësh, duke qenë nga të parët që është marrë me këtë çështje (që nga viti 1980), ai ka pasur rastin të intervistojë protagonistët e ngjarjeve direkte në luftime dhe që kanë pasur djepin për zhvillimet në zonën e Bulqizës dhe më gjerë. Kjo lëndë e parë e vjelë nga protagonistët, e ballafaqur me dokumentet arkivore, i kanë dhënë autorit fushë pamjen e mjaftueshme dhe shtegun e duhur për të dalë në konkluzione mjaft të qarta. Autori ka përmbledhur në 307 faqe të librit të tij gjërat thelbësore por edhe detaje të veçanta që s'janë thënë më parë në historinë e Bulqizës në 2-3 shekujt e fundit. Autori e ka ndarë punën e tij në katër kapituj themelorë, duke ruajtur madje dhe një baraspeshë në volum për secilin prej tyre, gjë që reflekton dimensionin intelektual e deri akademik të tij, pasi zbaton rigorozisht kriteret shkencore të pasqyrimin të një nisme të tillë. Në kapitullin e parë autori Bashkim Lami na njeh me situatën ku ndodhej Bulqiza para vitit 1912, kryengritjet e shumta antiosmane, organizimi vendor, prijesit, çetën e Bulqizës si dhe fiset më të njohura e më me ndikim në zonë. Në kapitullin e dytë na njeh me valën e parë të pushtimit serb, që korrespondon me fundin e vitit 1912 dhe fillim-vitin 1913, masakrat e përbindshme të pushtuesit, rezistencën e bulqizakëve, vendin e zhvillimit të ngjarjeve dhe të rënës në luftë. Në kapitullin e tretë, autori na njeh kryesisht me valën e dytë të pushtimit serb, pra 1918 deri në vitin 1921, me ngjarjet kryesore, me protagonistët, luftëtarët dhe dëshmorët, por edhe me tiparet politike të atyre viteve, marrëdhëniet me zonat e tjera, raportet me qeverinë e Lushnjës etj. Në pjesën e katërt e të fundit, autori ka vëllimin thelbësor të trajtesës, pasi ai hyn në detaje të ngjarjeve, të personazheve, të kuvendeve, të marrëdhënieve ndërkrahinore, mbi avantazhet dhe dobësitë politike e deri tek analiza e figurave qendrore të rezistencës.



BABA FEJZË SALI CANGA, "SHKËNDIJA E PARË" E LIRISË
Në këtë kapitull autori vë në rend kronologjik figurat më të rëndësishme



të Bulqizës, duke nisur me drejtuesit e Teqesë së Madhe, një varg shehlerësh e dervishësh me kontribute të rëndësishme, si dhe me ndikim në Bulqizë e më gjerë. Nuk mungon baba Fejzë Canga, një patriot i madh bulqizak e shqiptar, i cili iu kundërvu pushtetit osman deri në atë pikë sa udhëhoqi një kryengritje të armatosur, që kulmoi me betejën e Xixullës në Martanesh në vitin 1860. Baba Fejza do të spikaste si një figurë e madhe fetare, por edhe një figurë e madhe e mendimit filozofik e patriotik. Portreti i tij liridashës do të mbushte shpirtërisht atdhetarët

në vitet e mëvonshme për pavarësi e dinjitet kombëtar. Fejzë Sali Canga, i përshkruar mjeshtërisht nga autori, larg dogmave dhe me këmbë në tokë, përbën një arritje në librin e Bashkim Lamit. Me interes është dhe trajtimi i personalitetit të Eba Muslimit, djalit të Sheh Fejzës. Sheh Myslimi ishte njeri i duruar, mjaft i matur, i mençur e kanunor. Po në pjesën e katërt, autori na sjell në vëmendje pushtetin e Karajit si qefali i vendit, duke nisur me Bajram Karajin e që u lartësua me Dalip Karajin.

MEHMET DURIÇI, PERSONAZHI QË MORI SHKËLQIMIN E MERITUAR NGA PENË E BASHKIM LAMIT

Natyrisht, në pikëpamjen tonë, puna origjinale e autorit është sjellja në fokusin kryesor të jetës dhe veprës së "Burrit të Maleve", Mehmet Duriçi, udhëheqës dhe strateg i kalitur në luftërat për liri të bulqizakëve. Mehmet Duriçi u lind në Vajkal, në vitin 1852, në një familje me ndjenja të shprehura patriotike, një familje që kishte dhënë shembuj të pjesëmarrjes në luftë kundër osmanëve gjatë rezistencës së Sheh Fejzës. Mehmet Duriçi e takojmë kudo, si njeri i mexhllisit, si organizator, një burrë i madh që u rreshtua krah burrave më të mëdhenj të Dibrës në fundshekullin XIX e fillimshekullit XX. Autori Bashkim Lami ka nxjerr në pah karakteristikat e këtij patrioti dhe gjithë veprimtarinë e tij si njeri i mendjes, i sofrës dhe i pushkës. Që më 1872 goditi karakollin turk në Urën e Qytetit dhe krijoi çetën e tij. Me kalimin e viteve Mehmeti arrin ta konsolidojë çetën e tij dhe ishte po Mehmeti, që u vu në ballë të rezistencës bulqizake ndaj agresionit dhe mizorive serbe mes viteve 1912-1921. Tashmë ai ishte bërë një figurë kyçe e rezistencës jo vetëm në Bulqizë, por në mbarë Dibrën, aq sa, në vitet 1920-1921 të gjithë funksionarët më të lartë të qeverisë së dalë nga Kongresi i Lushnjës dhe më pas qeveria e Tiranës, zbarkonin tek kulla e Duriçeve në Bul-

të 70-tave. Si askush tjetër në Dibër, Mehmet Duriçi vuri në vijën e parë të frontit djemtë e tij, familjarët e tij, disa prej të cilëve ranë dëshmor. Ky ishte një akt i pashembullt atdhedashurie. Ai e shpenzoi tërë pasurinë e tij për atdheun dhe ishte prej atyre që në fund të luftës 9-vjeçare me krahjet, ishte po aq i varfër sa edhe familjet e tjera bulqizake. Kjo pasi ai i kishte dhënë gjithçka luftës dhe mbrojtjes së Bulqizës e mbarë Dibrës. Historiografia jonë ka shkruar pak për Mehmet Duriçi, pasi ai nuk ka pasur sekretar personal sikurse kanë pasur disa të tjerë, nuk ka pasur as pushtet financiar e politik, por dokumentet arkivore dhe fryma popullore e mbajnë lart këtë figurë emblematike të Bulqizës (dhe jo vetëm) në ngjarjet e mëdha e dramatike para e pas shpalljes së pavarësisë. Ky burrë i madh bulqizak, vdiq në vitin 1925 në moshën 72 vjeçare, duke lënë pas një emër të mirë, një histori të mbushur me atdhedashuri.

MASAKRA E SERBËVE NDAJ SHABËVE NË DRAGU DHE KUNDËR PËRGJIGJIA POPULLORE

Autori është ndalur edhe tek disa ngjarje të bujshme historike sikurse është lufta në kullën e Shabës (ku u masakrua e tërë familja 7-anëtarëshe e Sul Shabës në Dragu), në kullën e Muçës, në kullën e Licit, në Vajkal tek Gurët e Skënderbeut, apo në aksionet kundër serbëve në Urën e Qytetit. Duhet thënë se nga këto masakra të përbindshme që bënë serbët në Bulqizë, kanë humbur jetën me dhjetëra vetë të pafajshëm, janë djegur mbi 30 shtëpi, ka pasur rrëmbime të pasurisë dhe tortura nga më çnjerëzoret. Për 9 vjet me radhë, duke tentuar të kapin e mbajnë qafën e Buallit, me pretekstin e "vijave strategjike", serbët bënë terror masiv, shkuan në thikë e dogjën për së gjalli pleq e plaka e deri fëmijët e djepit. Në punimin e Bashkim Lamit, krahas analizës së ngjarjeve e personazheve kryesorë, pasqyrohet edhe jetesa e bulqizakëve në dy shekujt e fundit, si organizoheshin fiset dhe çfarë marrëdhëniesh kishin ata me parinë dhe klerin. Një tjetër dimension i trajtesës së autorit është lëvizja kaçake në Bulqizë, ku na sjell të dhëna të reja për veprimtarinë e Sul Hupit dhe grupit të tij. Trajtesa e këtij personazhi bëhet duke marrë të mirat dhe të këqijat, pasi, siç dihet, Sul Hupi ka qenë një personazh kontrovers, me disa arritje në aspektin e luftës kundër turqve, por nga ana tjetër mjaft mizor. Bashkim Lami ka rrëfyer me një gjuhë të thjeshtë, të kuptueshme, pa ngjyrim e pa tepri, duke u bazuar vetëm në fakte.

Është kuptimplote dhe mjaft e dobishme, po ashtu, përmbyllja e studimit të autorit Bashkim Lami, i cili na njeh me dëshmorët e Bulqizës. Kjo armatë dëshmorësh qëndron sot si kurorë lavdie e pavdekësie në luginën e Bulqizës, ku historia është shkruar me shpatë, me pushkë e me gjak. Libri "Qëndresa e bulqizakëve në luftërat për liri" e Bashkim Lamit, shënon kështu një "gur kilometrik" të dallueshëm e të rëndësishëm në studimet historike në Dibër e më gjerë, ndërsa vetë autori është kujdesur që kjo çështje të jetë e hapur për analizë të mëtejshme. Duke e përmbjllur, po citojmë vetë autorin në shënimet e tij në fund të librit: "Ky popull, i varfër por me shpirtin e madh të dragoit, në kushtet e një terrori masiv, nuk u përku asnjëherë gjatë shekujve, deri në ditët e fitores së lirisë, ai arriti të mbijetojë dhe shkroi historinë e tij me gjak e sakrificë që nuk harrohen".

SHOQATA BULQIZA
Adibetare Kulturorë

PROGRAMI I SESIONIT SHKENCOR

Autorë bulqizakë në studime historike
Prezantim i librave historike të autorëve bulqizakë:
➤ Bashkim Lami me studimin "Qëndresa e Bulqizakëve për liri"
➤ Ymer Keta me studimin "Bulqiza dhe bulqizakët"
➤ Kadri Dauti dhe Arif Shutina me librin "Kalabardha këshqjellë e Arbërisë"
➤ Agim Demiri me fjalorin "Nga e folmja e Bulqizës"
➤ Destan Rama me librin "Yje që ndriçojnë Bulqizën"

Gjeografia e Bulqizës
➤ Dr. Adriatik Balla paraqet kumtesën "Një vështrim fiziko-gjeografik i trevës së Bulqizës"

Jeta shpirtërore e Bulqizakëve
➤ Ramazan Kica mban kumtesën "Hulumtim dhe gjetje mbi tabanin e këngës folklorike Bulqizake"

Përcënim i çmimit "Lutfi Hanku" për krijues letrarë në prozë e poezi
➤ Shoqata Bulqiza do ta japë çmimin "Lutfi Hanku" për krijuesit në art dhe në letërsi

Në krijimtaria e poetëve bulqizakë (recitime)
➤ Prezantohen autorët: Barie Çupi, Arben Alliu, Bruna Musai, Donika Gjura, për krijimtari të tyre dhe botimet me poezi.

Krijimtaria e skulptorit bulqizak Etmond Balja
➤ Me kumtesën: "Krijimtaria e skulptorit bulqizak Etmond Balja dhe projektet e tij që presin të zbatohen për të krijuar atraksione të reja turistike me vepra arti të gjimve të ndryshme".

Stilistat e kostumeve popullore të trevës së Bulqizës
➤ Dr. Albana Leti, paraqet kumtesën: "Veshjet tradicionale të krahinave, Zerqanit, Martaneshit e Gollibordit, një vlerë e çmuar e trashëgimisë tonë dhe përpjekjet e stilistëve të rinj për ta mbajtur gjallë traditën".

➤ Prezantohet puna dhe veprimtaria e stilistëve: Selvije Koçi, Nexhmije Lala, Mëke Gjini, Albana Gjinaj, që mbajnë gjallë trashëgiminë e veshjeve tradicionale.

Këngë e valle autoktone të Bulqizës
➤ Këngëtarë e valltarë të Qendrës Kulturorë të Fëmijëve Bulqizë.

Doktrime e vlerësime
➤ Për studjuesit, krijuesit, stilistët dhe interpretuesit e vlerave historike e kulturore të Bulqizës.

Organizimi:
Shoqata Bulqiza; Qendra Kulturorë e Fëmijëve Bulqizë.
Moderon aktivitetin: Edison Balla.
Bashkëpunim me: Bashkinë Bulqizë.
Sponsor gjeneral: ALBSIG.

Bulqizë, më 1 tetor 2022



Presidenti i "Shoqatës Bulqiza", Prof.assoc.dr.Islam Dauti ju bëri të ditur pjesmarrësve vendimin e kryesisë për dhënien e çmimit "Lutfi Hanku" krijuesve e botuesve të talentuar në art e letërsi

HISTORI - KULTURË - LETËRSI - TRADITË, SESION SHKENCOR NË FUSHË-BULQIZË

EGLANTINA ALLIAJ
"SHOQATA ATDHETARE KULTURORE BULQIZA" para pak kohësh ka organizuar SESIONIN SHKENCOR me tematikë "HISTORI - KULTURË - LETËRSI - TRADITË", në Fushë Bulqizë. Morën pjesë drejtues të "Shoqatës Bulqiza", që organizuan aktivitetin sipas programit të shpallur më parë, z.Lefter Alla, Kryetari i Bashkisë Bulqizë; z.Gëzim Xhafa, Kryetari i Këshillit bashkiak, z.Selim Alliu, kryetari i Njësisë Administrative Fushë Bulqizë; z. Rakip Koka, kryetari i "Shoqatës Martaneshi", studjues të historisë, referues studimesh, poetë, stilistë këngëtarë, valltarë, shumë të ftuar, etj. Gjithë aktiviteti u ndoq me shumë interes nga pjesmarrësit gjatë të gjithë etapave të programit të përgatitur më së miri. Aktiviteti u moderua nga z.Asllan Daxha, anëtar i kryesisë së "Shoqatës Bulqiza".



STUDIUESVE TË HISTORISË E KULTURËS SË BULQIZËS U JEPET ÇERTIFIKATA MIRËNJOHJE NGA BASHKIA BULQIZË
Në këtë sesion shkencor u promovuan studimet historike të disa autorëve nga zonat e Bulqizës. Studiuesi Bashkim Lami paraqiti përpara pjesmarrësve librin "Qëndresa e Bulqizakëve për liri" si studim i kryer në disa vite. Ymer Keta me studimin "Bulqiza dhe bulqizakët". Z.Ferhat Gruja, aktivisti i shoqatës "Hazis Lila" paraqiti një përshkrim të studimit të autorëve Kadri Dauti e Arif Shutina në librin e tyre "Kalabardha këshqjellë e Arbërisë". Agim Demiri paraqiti botimin e tij FJALOR "Nga e folmja e Bulqizës" dhe Destan Rama librin "Yje që ndriçojnë Bulqizën". Autorët shprehën me emocion, por dhe krenari mendime interesante mbi përpjekjet e tyre deri në realizimin e botimit të librave që pasqyrojnë vlerat e mëdha të historisë, kulturës e traditës së trevës së Bulqizës. Dr.Jashar Demiri vlerësoi lart punën e studjuesve dhe të poetëve që e kanë mbushur tav-

olinën me libra që duan shumë mund e përpjekje për të qenë botimi në dorë të lexuesve dhe e krahasoj me ndërtimin e një kulle nga themelet.
Z.Lefter Alla shprehu mirënjohjen e tij për autorët e këtyre studimeve duke thënë se ato tashmë janë një vlerë e çmuar për njohjen e historisë së qëndresës së popullit të Bulqizës në luftat për liri e pavarësi. Më pas z.Alla nderoi me certifikata mirënjohje autorët e këtyre studimeve. Doktorin i shkencave gjeografike Adriatik Balla paraqiti studimin e tij "Një vështrim fiziko-gjeografik i trevës së Bulqizës", ku evidentoj vlerat e mëdha të natyrës së maleve të Bulqizës, sidomos zonat me liqene akullnajore si vende që mund të kthehen në atraksione turistike mjaft të pëlqyeshme për vizitorë vendas e të huaj. Ai bëri krahasimin me zona të ngjashme malore të Italisë e vendeve të tjera që kanë të njëjtat karakteristika me zonat e liqeneve të Duriçit, Martaneshit, Zerqanit, Allamanit, Balgjait, etj. Autor i studimit theksoj që qeverisja vendore e qëndrore, duhet të kthejnë vemendjen tek këto resurse të natyrës malore të Bul-

qizës për të tërhequr lëvizjet e turistëve, si mundësi për shtimin e punësimit e të të ardhurave për ekonominë e vendit.
Studiuesi Ramazan Kica mbajti kumtesën "Hulumtimet dhe gjetjet mbi tabanin e këngës folklorike Bulqizake" që tërhoqi vemendjen e pjesmarrësve. Ai shprehu bindjen e tij se është shumë e rëndësishme të vërtetojmë autoktoninë e këngëve të Bulqizës dhe të vlerave të tjera historike, gjuhësore, etnografike, etj.

ÇMIMI "LUTFI HANKU" PËR POETËT E TALENTUAR BULQIZAKË
Presidenti i "Shoqatës Bulqiza" prof. assoc.dr.Islam Dauti ju bëri të ditur pjesmarrësve vendimin e kryesisë për dhënien e çmimit "Lutfi Hanku" krijuesve e botuesve të talentuar në art e letërsi. Kjo bëhet për të nderuar veprën e shkrimtarit me romanet "Drita e shpirtit", "Erdhi Caushi", "Loti rebel", etj. Në nderim të të ndjerit Lutfi Hanku u mbajt një minutë heshtje. Çmimi "Lutfi Hanku" ju dha për herë të parë poetëve Barie Çupi për botimin e librit me poezi VARGËNJTË E FATIT; Bruna Musai për botimin e librit me poezi ENDËRRA E MBETUR NË SIRTAR, Donika Gjura për botimin e librit me poezi PRANVERË NË VARGJE dhe Arben Alliu për botimin e tij me poezi ME TY, PËR TY, BULQIZË. Poetët paraqitën për pjesmarrësit recitim e poezive të tyre të zgjedhura.
Kryetari i "Shoqatës Bulqiza" z.Bashkim Lami paraqiti para pjesmarrësve aktivitetin e shquar të shoqatës prof. assoc. dr. Islam Dauti, doktorin e shkencave gjeografike Adriatik Balla, doktorin

e shkencave psikologjike Jashar Demiri, mësuesit e aktivistët Hamit Dervishi e Medin Karaj, inxhinierin gjeolog të talentuar Sefedin Shabani, mësuesin aktivist Asllan Daxha, pedagogun Edison Balla, skulptorin e talentuar Etmond Balja, etj. të cilët i japin gjallëri punës në shoqatë, për të vlerësuar punën e arritjet e njerëzve të shquar nga krahinat e Bulqizës.

STILISTET QË MBUSHIN DASMAT E AKTIVITETET ME KOSTUME POPULLORE


U mirëpritën me kërkësi paraqitjet e punëve të stilistëve Nexhmije Lala të kostumeve popullore të Zerqanit, Albana Gjinaj të Martaneshit dhe Selvije Koçi të Bulqizës, të cilat me duart e tyre si mjeshtrë të qëndisjes, po punojnë me përkushtim për ruajtjen e vlerave të veshjeve tradicionale, duke zbukuruar aktivitetet publike e gëzimet familjare në fshat e në qytet, në Bulqizë, Tiranë e kudo. Kryesia e shoqatës u dha certifikata mirënjohje zonjave qëndistare duke ju uruar që punët e tyre të stolisin të rinjë të reja me këto vlera të etnografisë tonë.
Çertifikata mirënjohje u dhanë nga kryesia e "Shoqatës Bulqiza" edhe për mësuesin e muzikantit veteran Shaban Demiri, muzikantit e talentuar Leonard Lala, skulptorin Etmond Balja, aktivistin e problemeve sociale Edison Balla, studiues e krijues të tjerë. Aktivitetin e ndezën këngët e bukura autoktone "Kulla e Shabës", "Or bari e oj bareshë", "Cuca vesh fustan jeshile" të kënduara nga këngëtarët e talentuar Adem Ceni, Anxhela Përkola, Edi Laçi, etj. Po ashtu edhe valltarët Sinan Alliu e Saba Çupi si gjithmonë na dhanë kënaqësi me vallet autoktone të Bulqizës.
Falenderime për sponsorin ALBSIG dhe për stafin e restorant "STONE" ku u realizua ky aktivitet. Falenderim meritonjë edhe vëllezërit Qerim e Defrim Karaj për regjistrimin e fotot e aktivitetit, si dhe për muzikantit Xhevat Demiri që mbajti gjallë atmosferën festive. Z.Bashkim Lami në mbyllje të aktivitetit u tha pjesmarrësve, se të gjithë meritojnë shumë falenderime, orgnizatorët dhe të gjithë aktivistët që mundësuan realizimin e këtij sesioni shkencor, si tribunë e evidentimit e të ruajtjes së vlerave të historisë e kulturës së Bulqizës. Shpresojmë që në të ardhmen të kemi edhe aktivitete të tjera promovuese vlerash të vendlindjes tonë të dashtur.




fotoreportazh

Fabrika pasurimit Kromit sh.p.k
Bulqizë

Prodhimi i mineralit dhe koncentratit te kromit ne vite




Numri i punonjese ne objektet minerare dhe perpunuese



Fabrika pasurimit Kromit sh.p.k
Bulqizë

INVESTIMET DHE TREGUESIT E PRODHIMIT GJATE VITEVE

Prodhimi i koncentratit te kromit ne vite



Investimet e realizuara ne vite kapin ne total shifren prej 5.2 milion USD
 Ne teknologji 4.0 milion USD
 Ne rehabilitim mjedisor 1.2 milion USD

FABRIKA E PASURIMIT TË KROMIT BULQIZË ME SIPËRMARRËS BUKUROSH KOÇIN, NDËR MË TË SUKSESSHMET NË RANG VENDI

